



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 14 dhjetor 2018
Nr. ref.:RK 1299/18

VENDIM PËR REFUZIM TË KËRKESËS

në

rastin nr. KI121/18

Parashtrues

Gëzim Murati

**Vlerësim i kushtetutshmërisë së vendimeve ose akteve të
paspecifikuara të autoriteteve publike**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Gëzim Murati, me vendbanim në Mitrovicë (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës).

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës nuk e konteston ndonjë vendim apo akt të veçantë të një autoriteti publik.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së vendimeve ose akteve të paspecifikuara të autoriteteve publike, me anë të të cilave parashtruesi i kërkesës pretendon se atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 25 [E drejta për Jetën], 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 44 [Liria e Asociimit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 51 [Mbrojtja Shëndetësore dhe Sociale] dhe 120 [Financat Publike], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në paragrafin 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, në nenin 47 [Kërkesa Individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i Kërkesave dhe Përgjigjeve] të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 16 gusht 2018, Gjykata Kushtetuese e Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata) pranoi kërkesën e parashtruesit të kërkesës të cilën ai e kishte dorëzuar në Postën e Kosovës më 14 gusht 2018.
6. Më 2 shtator 2018, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërxhaliu-Krasniqi.
7. Më 2 tetor 2018, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës si dhe kërkoi nga ai: të specifikojë aktet ose vendimet e autoriteteve publike të cilat i konteston, të sqarojë ankesat e tij sipas Kushtetutës, si dhe të dorëzojë kopjet e dokumenteve dhe informatat tjera që mbështesin pretendimet e tij.
8. Më 10 tetor 2018, parashtruesi i kërkesës dorëzoi në Gjykatë një shkresë me të cilën specifikoi të drejtat kushtetuese për të cilat ankohet, dorëzoi disa dokumente në lidhje me Organizatën Joqeveritare, Shoqata "Vendi im" (në tekstin e mëtejme: OJQ "Vendi im"), si dhe dorëzoi disa raporte mjekësore.
9. Më 22 nëntor 2018, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarës raportuese dhe njëzëri i rekomandoi Gjykatës që ta refuzojë kërkesën me procedurë të shkurtër.

Përmbledhja e fakteve të rastit

10. Parashtruesi i kërkesës pohon se atij nuk i është mundësuar nga Komuna e Mitrovicës që të zhvillojë aktivitetin e tij përmes OJQ-së “Vendi im”.
11. Parashtruesi i kërkesës nuk ka dorëzuar dhe specifikuar para Gjykatës ndonjë akt apo vendim të ndonjë autoriteti publik të cilin ai e konteston.
12. Ai i ka bashkëngjitur kërkesës së tij disa dokumente, ndër të tjera, Certifikatën e regjistrimit dhe Statutin e OJQ-së “Vendi im”, Diplomën e tij të studimeve, letërnjoftimet e themeluesve të OJQ-së “Vendi im”, si dhe disa raporte mjekësore.

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

13. Parashtruesi i kërkesës pretendon se me veprimet e Komunës së Mitrovicës, atij i janë shkelur të drejtat e garantuara me nenet 23 [Dinjiteti i Njeriut], 25 [E Drejta për Jetën], 31 [E Drejta në Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], 32 [E Drejta për Mjete Juridike], 44 [Liria e Asociimit], 49 [E Drejta e Punës dhe Ushtrimit të Profesionit], 51 [Mbrotjtja Shëndetësore dhe Sociale] dhe 120 [Financat Publike], të Kushtetutës.
14. Parashtruesi i kërkesës pohon se *“[ankohet kundër Komunës së Mitrovicës për padrejtësinë në pamundësimin e hapjes së një organizate joqeveritare bamirësie humanitare ‘Vendi im’], duke shtuar më tej se ‘Kryetari [A. B.] të cilin e kam përkrahur (mbështetur) nuk më hap zyrën qëllimisht [...]’.* Ai gjithashtu pohon se *“drejtorin e financave nuk e gjej në zyrë, [ndërsa] që 10 vite jam i shkelur nga shteti i korruptuar të cilit i jap taksa 20 vite”.*
15. Parashtruesi i kërkesës pretendon se, bazuar në nenin 120 [Financat Publike] të Kushtetutës, ka kërkuar *“[...] nga zyrtarët e thesarit t’i ndajnë fondin konform Kushtetutës të garantuar me financimin e projektit start up ‘Vendi im’”.* Ai sqaron se të drejtat e tij kushtetuese mohohen për shkak të *“interesave partiake të subjekteve siç janë AKR, dhe LVV dhe shoqëria civile dhe mediat joserioze [...]”.*
16. Ai po ashtu pohon se *“dëshiroj vend pune, jetesë normale dhe njerëzore, jo partitë politike të më kushtëzojnë [...], gjithë shteti duhet të funksionojë, jam për të respektuar ligjin por jo edhe gjunjëzimin [...]”.*
17. Në lidhje me shterimin e mjeteve juridike, parashtruesi pohon se *“nuk ka institucion publik ose të huaj që nuk jam ankuar. Komuna nuk më jep të drejtat ligjore”.* Ai po ashtu shtron pyetjen *“më tregoni a ka ndonjë mjet juridik që është funksional në Kosovë përveç gjyqësorit më të lartë kushtetues [...]?”.*
18. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu në shkresën e tij të 10 tetorit 2018 thekson se, për shkak të shkeljes së të drejtave të tij dhe traumave që më janë shkaktuar *“konstatojë se duhet kompensuar 100.000 Euro”.*

Pranueshmëria e kërkesës

19. Gjykata Kushtetuese, para se të shqyrtojë një kërkesë, së pari vlerëson nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë dhe të specifikuara më tej me Ligj dhe me Rregullore të punës.

20. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

21. Në vazhdim, Gjykata gjithashtu i referohet kritereve të pranueshmërisë, siç përcaktohen me Ligj. Në lidhje me këtë, Gjykata së pari i referohet nenit 47 [Kërkesa individuale] dhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, të cilët përcaktojnë:

Neni 47 [Kërkesa individuale]

*“1. Çdo individ ka të drejtë të kërkojë nga Gjykata Kushtetuese mbrojtje juridike në rast se pretendon se të drejtat dhe liritë e tij individuale të garantuara me Kushtetutë janë shkelur nga ndonjë autoritet publik.
(...)”.*

Neni 48
[Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

22. Në vlerësimin nëse parashtruesi i kërkesës i plotëson kriteret kushtetuese dhe ligjore për vlerësimin e kushtetutshmërisë së kërkesës së tij, Gjykata rikujton se në bazë të nenit 113 të Kushtetutës, individët janë të autorizuar të ngrenë në Gjykatë shkeljet e pretenduara të të drejtave dhe lirive themelore të garantuara me Kushtetutë nga “autoritetet publike”, pasi të kenë shteruar mjetet juridike të përcaktuara me ligj. I njëjti kriter është po ashtu i përcaktuar në nenin 47 të Ligjit.
23. Për më tepër, neni 48 i Ligjit specifikisht detyron parashtruesit e kërkesave që të qartësojnë saktësisht aktin konkret të autoritetit publik të cilin e kontestojnë. I njëjti nen, gjithashtu i detyron parashtruesit e kërkesës që të qartësojnë saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendojnë të jenë cenuar.
24. Në rrethanat e rastit e konkret, parashtruesi i kërkesës nuk ka specifikuar aktin e autoritetit publik të cilin e konteston dhe nuk ka sqaruar ankesat e tij sipas Kushtetutës. Rrjedhimisht, kërkesa e parashtruesit të kërkesës nuk i plotëson kriteret e pranueshmërisë të përcaktuara me Kushtetutë dhe Ligj.
25. Në lidhje me këtë, Gjykata i referohet paragrafit 4, të nenit 22 [Procedimi i kërkesës] të Ligjit, i cili përcakton:

“Nëse kërkesa [...] nuk është e [...] kompletuar, gjyqtari raportues njofton palët apo pjesëmarrësit përkatës për këtë dhe ia cakton një afat prej jo më shumë se 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve për të [...] plotësuar kërkesën [...]”.

26. Më tej, Gjykata gjithashtu i referohet rregullit 32 (2) (h) [Parashtrimi i kërkesave dhe i përgjigjeve] dhe rregullit 35 (5) [Tërheqja, hedhja poshtë dhe refuzimi i kërkesës], të Rregullores së punës, që përcakton:

“32 (2) Kërkesa, po ashtu, duhet të përmbajë edhe:

[...]

(h) informacionet dhe dokumentacionin mbështetës.

[...]

35 (5) Gjykata mund të vendosë të refuzojë një kërkesë me procedurë të shkurtër në qoftë se kërkesa është e paplotë ose e paqartë përkundër kërkesave të Gjykatës ndaj palës që të plotësojnë apo qartësojnë kërkesën, [...]”.

27. Gjykata vëren se thelbi i pretendimeve të parashtruesit të kërkesës ka të bëjë me ankesat e tij se autoritetet publike, veçanërisht Komuna e Mitrovicës, nuk i ka mundësuar atij ushtrimin e veprimtarisë përmes OJQ-së “Vendi im”.
28. Megjithatë, ai nuk dorëzoi asnjë akt ose vendimet e autoriteteve publike të cilat pretendon se i kanë shkelur atij të drejtat e garantuara me Kushtetutë.
29. Në lidhje me këtë, Gjykata rikujton se me 2 tetor 2018, në pajtim me nenin 22.4 të Ligjit, i kërkoi parashtruesit të kërkesës të specifikojë aktet ose vendimet e autoriteteve publike të cilat i konteston, të sqarojë ankesat e tij sipas Kushtetutës si dhe të dorëzojë kopjet e dokumenteve dhe informatat tjera që mbështesin pretendimet e tij.
30. Parashtruesi i kërkesës me shkresën e 10 tetorit 2018, megjithëse specifikoi të drejtat kushtetuese që ai pretendon se janë shkelur nga autoritetet publike dhe dorëzoi disa dokumente, ai nuk dorëzoi dhe nuk specifikoi asnjë akt apo vendim të autoriteteve publike kushtetutshmëria e të cilëve do të mund t'i nënshtrohej vlerësimit kushtetues nga Gjykata, ashtu siç i ishte kërkuar nga Gjykata me shkresën e 2 tetorit 2018.
31. Andaj, Gjykata nuk mund t'i marrë për bazë pretendimet e parashtruesit të kërkesës, për shkak se kërkesa është jo e plotë, pasi nuk janë specifikuar dhe bashkëngjitur vendimet e autoriteteve publike të kontestuara (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, K103/15, parashtrues: Hasan Beqiri, të 13 majit 2015, paragrafi 19, si dhe rastin e Gjykatës Kushtetuese K107/16, parashtrues: Rifat Abdullahi, të 14 korrikut 2016, paragrafi 22).
32. Në këtë drejtim, Gjykata thekson se përgjegjësia për përmbushjen e kriterëve formale-procedurale, ashtu siç kërkohet me Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës, bie mbi parashtruesit e kërkesave nëse dështojnë ta bëjnë një gjë të tillë. (shih, *mutatis mutandis*, rastin e Gjykatës Kushtetuese, K130/17, parashtrues: Ndue dhe Simon Palushaj, paragrafi 26).

33. Rrjedhimisht, Gjykata përfundon se kërkesa e parashtruesit nuk i përmbush kriteret siç përcaktohet me Rregulloren e punës, për shkak të arsyeve të sipërcekura.
34. Si përmbledhje, Gjykata konsideron se kërkesa e parashtruesit, nuk i përmbush kriteret procedurale për shqyrtim të mëtejshëm, për shkak të moskompletimit të saj me dokumentacion mbështetës, ashtu siç kërkohet me nenet 48 dhe 22.4 të Ligjit dhe me rregullat 32 (2) (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës.
35. Prandaj, Gjykata përfundon se kërkesa duhet të refuzohet me procedurë të shkurtër.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 48 dhe 22.4 të Ligjit dhe në pajtim me rregullat 32 (2) (h) dhe 35 (5) të Rregullores së punës, më 22 nëntor 2018, njëzëri

VENDOS

- I. TË REFUZOJË kërkesën;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese



Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese



Arteta Rama-Hajrizi